



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

## E K S T R A K T

i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport, mbajtur më 16.12.2022, duke filluar në orën 16:00.

Në mbledhje morën pjesë: Valbona Ajeti (AAK), kryesuese, Gresa Lahu (PDK), Endrit Zabërgja (NISMA) dhe Adelina Mehiu, eksperte e jashtme.

Të pranishëm ishin edhe: Arta Balaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës dhe Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit.

Mbledhjen e hapoi dhe e kryesoi Valbona Ajeti, kryesuese e komitetit dhe propozoi këtë

### REND TË DITËS:

1. Miratim i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Kulturë Rini dhe Sport;
2. Definimi i programit kulturor për fund vit;
3. Rishikimi i Projektregulloreve të subvencioneve të kulturës dhe sportit;
4. Informatë e punës gjashtë mujore të Drejtorisë së Kulturës dhe Sportit;
5. Të ndryshme.

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua rendi i ditës.

#### Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport.

#### Pika e dytë

Definimi i programit kulturor për fund vit

Faqe 1 nga 4

Arta Balaj, drejtore i njoftoi të pranishmit rreth definimit të programit kulturor për këtë fund vit e cila tha se të gjitha aktivitetet kulturore mbahen duke filluar nga dt. 24.12.2022, në sheshin "Xhorxh Bush", ku të gjitha këto programe do të fillojnë në ora 20:00. Në këto aktivitete do të marrin pjesë këngëtar dhe grup të ndryshme muzikor si ato:

- Më 25.12.2022, e kemi Linda Hakaj, Saranda Imeri - Stafaj, Nysret Muçiçi me grupin Corona;
  - Më 26.12.2022, e kemi Miranda Hashani, Neki Emra, Corona, Rizah Bytyqi plus dy vokalistë të tjerë;
  - Më 27.12.2022, e kemi grupi String String, Shpend Hysaj, Teuta Kurti, Ndriqim Gazija, Blendi dhe DJ;
  - Më 28.12.2022, e kemi Emir Plava, Arbër Krasniqi, Ernesa Surdulli, Xuxi me bend, dhe në fund DJ;
  - Më 29.12.2022, e kemi Diana Toska, Jehona Luki, Genc Krasniqi dhe Yll Havolli, Sidorela Kelmendi, Frontina Krasniqi dhe në fund DJ;
  - Më 30.12.2022, Rona Nishliu me bendin e vet, dhe ky aktivitet muzikor përfundon më 31.12.2022, ku do të vazhdoi deri në ora 00:30 pas mesnate;
- Sa i përket ndriçimit dhe dekorimit të sheshit tha se këtë vit mjetet financiare nuk kanë qenë të mjaftueshme, ka qenë pak më i kufizuar por edhe përkundër asaj ne kemi bërë ndriçimin dhe dekorimin e shesheve "Skënderbeu Nëna Terezë edhe Zahir Pajaziti", si dhe e kemi zhvendosë edhe një pjesë të ndriçimit edhe të kampit shtëpizat, si dhe disa ndriçime dhe dekorime i kemi bërë edhe në rrugën "Xhorxh Bush".

**Valbona Vitija**, kryesuese dhe **Granit Rugova**, drejtor falënderuan drejtoreshën rreth informimit për të gjitha këto aktivitete.

**Pika e tretë**

**Rishikimi i Projektregulloreve të subvencioneve të kulturës dhe sportit**

**Granit Rugova**, drejtor tha se sa i përket subvencionimit të kulturës dhe sportit, ne përveç bursave nuk kemi ndarë subvencione për individ, sportist elitë, ku si shembull konkret mundë ta marrim sportistin Granit Kuleta, është njëri prej tyre që ka marrë pjesë në një kampionat evropian në Spanjë dhe nuk kemi mundur me e përkrahë. Ne i kemi përkrahë vetëm klubet e ndryshme dhe disa OJQ, kështu mendoj se për ndarjen e subvencioneve për sportist të veçantë, kriteret duhet me qenë shumë strikte dhe ato kriteret duhet me u shqyrtuar prej një grupi ekspertësh, mos me lënë hapësirë, se aty mundë të aplikojnë më se 1 mijë sportistë e prej tyre duhet me i përkrahë 20, por në një farë mënyre që klubi i tyre përkrahet dhe ato mjete shkojnë të sportistët.

**Endrit Zabërgja**, tha se nëse ndonjëri prej sportistëve më të dalluar e meriton përkrahjen, pse mos të përkrahet si individ, kështu që përmes disa kriterëve mundet pak a shumë me u pezulluar ndoshta edhe mundësinë e aplikimit të dikujt, pa qenë në nivel të caktuar si sportist.

Faqe2nga4

**Granit Rugova**, drejtor tha se sportistët që marrin pjesë në gara elitare dhe që e përfaqësojnë qytetin së pari pastaj Kosovën, këtë e kam menduar si opsion, dhe mendoj se si ide mund të përkrahet, pra duhet shikuar që të kemi disa kritere strikte, kështu që do ta propozoj që në takimin e radhës me parapa si pikë të rendit të ditës, me ardhur me një propozim se si të veprohet më tutje.

**Arta Balaj**, drejtore tha se do të ishte mirë që subvencionimi me u shpall një herë në vit, me u shpall në mars, mendoj që duhet me qenë prej marsit deri në marsin e viti të ardhshëm, kështu që do të ishte mirë që me gjete mundësinë që me i përkrahë të gjithë, mos me mbet ndonjë vakum kohorë që ne disa aktivitete mos me i përkrahë.

**Granit Rugova**, drejtor tha se ato klube të cilat i përmbahen rregullores dhe raportojnë deri në mars mund t'i subvencionojmë, ndërsa klubet të cilat nuk e kanë bërë raportimin deri në këtë periudhë kohorë nuk mund të subvencionohen.

**Endrit Zabërgja**, kërkoi të dijë se aktivitetet të cilat bëhen përmes rinisë, a do të subvencionohen edhe ato.

**Granit Rugova**, drejtor tha se edhe disa nga aktivitetet rinore kanë me u subvencionuar, rinia shkon me projekte sportive dhe këto mund të bëhen dy herë brenda vitit dhe aty specifikohen se për çka përkrahet rinia, si për trajnime, pjesëmarrje në konferenca dhe ne në parim 20%, të buxhetit të subvencioneve e ndajmë për rini, për OJQ-në, rinore për aktivitetet e tyre.

**Valbona Vitija**, kryesuese tha se gjatë tërë vitit e di se ka qenë si traditë me ju dhënë shpërblime laureatëve të vitit.

**Granit Rugova**, drejtor tha se tani ne në muajin shkurt, e kemi parashikuar që të ndahen 25 mijë euro, për shpërblimin e klubeve më të mira dhe për sportisten dhe sportistin më të mirë.

**Arta Balaj**, drejtore tha se 100 mijë euro, nga subvencionet shkojnë vetëm për festivalet e mëdha, pastaj pajtohem që për rini, për dikë që për herë të parë aplikon po i ndajmë 300 mijë euro, kështu që sa herë që po bëhet thirrja për aplikim duhet me krijuar komision të ri, prandaj kërkoi të dijë se a ka mundësi me e krijuar një komision të përhershëm për 3 apo 4 vjet.

**Granit Rugova**, drejtor tha se sipas rregullores përparësi për subvencionim kanë ato aktivitete, koncerte të cilat janë në vazhdimësi dhe që kanë treguar sukses.

**Valbona Vitija**, kryesuese lidhur me ndryshimin e Rregullores për subvencionim të kulturës dhe sportit tha se këto ndryshime mundë të iniciohen në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe me ato ndryshime ajo mund të votohet në Kuvend.

**Granit Rugova**, drejtor tha se iniciativën për ndryshimin e kësaj rregullore duhet me e marrë të gjitha drejtoritë.

Arta Balaj, drejtoresha tha se është më se e rëndësishme që me u krijuar komisionet për vlerësimin e subvencioneve por edhe komisionet për vlerësimin e ankesave, e që këto komisione me qenë afatgjate.

Valbona Vitija, kryesuese ishte e mendimit që për themelimin e këtyre komisioneve paraprakisht të merret një opinion nga Zyra ligjore.

#### **Pika e katërt**

Anëtarët e komitetit vendosën që pika e katërt e rendit të ditës "Informatë e punës gjashtë mujore të Drejtorisë së Kulturës dhe Sportit", të shtyhet për mbledhjet e ardhshme.

#### **Pika e pestë**

##### **Të ndryshme**

Endrit Zabërgja, tha se do të ishte mirë që për vitin e ardhshëm të parashihet në buxhet një vijë buxhetore për patinazh.

Gresa Lahu, kërkoi të dijë arsyen, pse deri më tani nuk janë hapur ende shtëpizat në shesh.

Granit Rogova, drejtor tha se për çështjen e hapjes së shtëpizave në shesh është marrë një komision të cilin e ka formuar kabineti i kryetarit.

Valbona Vitija, kryesuese falënderoi drejtoreshën Arta Balaj dhe drejtorin Granit Rogova, si dhe anëtarët e komitetit për mbylljen e një viti me mbledhje të suksesshme dhe me urimin që edhe vitin e ardhshëm të kemi një vit shumë me të mirë.

Endrit Zabërgja, falënderoi të gjithë të pranishmit duke cekur se gjatë kësaj periudhe ne kemi mbërri me e pasur një grup të unifikuar, e që kjo besoj se është për shkak të energjive pozitive të secilit edhe uroj me vazhduar edhe vitin tjetër.

*Mbledhja përfundoi në orën 17:10.*

**Procesmbajtësi**  
**Arton Brahim**

**Kryesuesja e komitetit**  
**Valbona Vitija**



**Faqe4nga4**